



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2023:059151

Datë: 18.12.2024

Numri i dokumentit: 06619178

C.nr.143/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike të paditësit M.Xh nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson avokat Z.H nga Prishtina, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 418.65 Euro, jashtë shqyrtimit, me datë 18.12.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit M.Xh, me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që në emër të shpërblimit jubilar paditësit t’ia paguaj shumën prej 418.65 Euro, për 10 vite të fundit të përvojës së punës, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë data 03.03.2023, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm”.
- II. DETYROHET paditësi M.Xh, që në emër të përgjigjes në padi, të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale t’ia paguaj shumën prej 104,00 Euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditësi M.Xh, përmes të autorizuarit të tij avokat Z.H nga Prishtina, në këtë gjykatë me datën 03.03.2023, ka parashtruar padi për shkak të shpërblimit jubilar, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij Z.H nga Prishtina në padi ka theksuar se paditësi është i punësuar tek Drejtoria e Shëndetësisë Rahovec, respektivisht kanë lidhur kontrate pune me kohë të pacaktuar me të paditurin. Duke marrë parasysh kohën e nënshkrimit të Kontratës Kolektive Sektoriale përkatësisht të drejtat dhe detyrimet të cilat burojnë, të punësuarve sipas kësaj kontrate u njihet e drejta për shpërblim jubilar për vitet jubilarë nga punëdhënësi i fundit, sipas nenit 17 par. 3, ku të njëjtat të drejtat edhe pse janë përcaktuar shprehimisht, nuk iu ka njohur kategorive së punëtorëve të cilat i mbulon kontrata prej ditës së nënshkrimit - hyrjes në fuqi, datë 12.06.2018, e gjerë në momentin e parashtrimit të padisë. Andaj, duke u bazuar në faktet e dhëna në padi i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifave të OAK-së. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit përmes parashtrësës me datë 10.12.2024 ka bërë precizim dhe plotësim të padisë me të cilën e ka njoftuar gjykatën lidhur me shumën e kërkuar si rezultat i viteve të përvojës së punës.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përgjigje në padi të datës 20.04.2023, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurës, me arsyetim se është e pathemeltë dhe nuk i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 17.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018. Sipas listës së pagave të, lëshuar nga punëdhënësi vërtetohet se paditësi 20 vite jubilarë ka arritur në vitin 2013, ndërsa padinë e ka ushtruar në gjykate me datën 18.02.2023, përderisa Kontrata Kolektive Sektoriale ka qenë në fuqi nga data 12.06.2018 deri më 12.06.2021, në këtë mënyrë konsiderojmë se kërkesëpadia është parashtruar jashtë afatit ligjorë në kohën kur nuk ka pasur Kontratë Kolektive Sektoriale në fuqi. Kërkesëpadinë paditësit e ka mbështetur në dispozitat e nenit 17.32.2 të KKS-së, e cila ka qenë në fuqi nga data 12.06.2018 deri më 12.06.2021, ndërsa padinë e ka parashtruar në gjykatë në muajin shkurt 2023. Në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, të gjitha kërkesat në para nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afati prej tre (3) vitesh. Në vitin 2020 kur paditësi ka arritur 10 vitet jubilarë është përmbushur kushti për të kërkuar shpërblimin jubilar, nëse punëdhënësi në afatin prej 30 ditëve nuk paguar shpërblimin jubilar

pas plotësimit të kushteve të parapara në nenin 17.3 të KKS-së, punëtori shëndetësor ka mundur të parashtrijë padi në gjykatë për realizimin e shpërblimit jubilar në periudhën kur KKS ka qenë në fuqi. Kërkesëpadinë paditësi e ka mbështetur në dispozitat e nenit 17.32.2 të KKS-së, e cila ka qenë në fuqi nga data 12.06.2018 deri më 12.06.2021, ndërsa padinë e ka parashtruar në gjykatë në muajin shkurt 2023. Në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, të gjitha kërkesat në para nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afati prej tre (3) vitesh. Nga kjo rezulton se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, respektivisht e parashkruar sa i përket afateve ligjore prekluzive, sepse në periudhën e dorëzimit të padisë në gjykatë, në shkurt 2023, nuk ka pasur Kontrata Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në fuqi, për çka rezulton se e paditura nuk ka detyrim që paditësit ti paguaj mjetet në emër të kompensimeve sipas dispozitave të Kontratës që kanë implikime financiare. I propozoi gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 104.00 €uro, për përpilimin e përgjigjes në padi.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës QKMF "Fahredin Hoti", në Rahovec.

Me shikimin në listën e pagave Dhjetor 2022, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës në emër të M.Xh, gjykata ka vërtetuar se i njëjti themelon marrëdhënie pune pranë të paditurës, ka përvojë punë prej 29 vite dhe merr pagën neto në vlerë prej 418,65 €uro.

Ligji i Punës Nr.03/L-212, neni 90 par.5 e përcakton se " *Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*".

Kontrata Kolektive Sektoriale, qershor 2018, nenit 17 par.3 përcaktohet se " *Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore,*

*te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të ti”, ndërsa par.4 e përcakton se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.*

Gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit dhe e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit M.Xh për 10 vite të fundit të përvojës së punës, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet, për arsye se paga jubilarë jepet për çdo (10, 20 apo 30 vite përvojë pune të pa ndërprerë), pra i njëjti ka kërkuar 10 vite të fundit të përvojës së punës ndërsa me shikimin në listën e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës gjykata ka vërtetuar se i njëjti në vitin 2022 kishte përvojë punë prej 29 vite.

Gjykata thekson edhe një herë faktin se paditësi nuk mundet të kërkojë kompensimin për pagën jubilarë për 10 vite të përvojë pune të pa ndërprerë, dhe kjo përvojë të shkëputet nga përvoja e tërësishme që në rastin konkret është 29 vite, pasi që dispozita e kontratës sektoriale janë të qarta kur flasin për pagën jubilarë dhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate paga jubilarë për 10 vite përvojë pune është dashur të kompensohej në vitin jubilar (10 vjetor), dhe kështu të vazhdohej në vitet tjera jubilarë (20 dhe 30) vite përvojë pune të pandërprerë, po ashtu kontrata kolektive sektoriale vlen deri me datë 11.06.2021, pra koha kur paditësi ka parashtruar padinë 03.03.2023, nuk ka pasur kontratë sektoriale në fuqi. Andaj gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është në kundërshtim me bazën ligjore dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e paditësit është refuzuar.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 399 par. 1 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se: *” Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. 399.2 Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Bazuar në dispozitat e nenit 399 të LPK-së gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret,

kërkesëpapia e paditësit ishte qartazi e pa themeltë, nuk ka bazë në dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Kontratës Kolektive Sektoriale, qershor 2018.

Gjykata analizoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo vlerësoj se të njëjtat janë të pa bazuara në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që paditësi është i obliguar të paditurës t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 104.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të përgjigjes në padi.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 399 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.143/2023, me datë 18.12.2023.

B. Profesionale

Shpresa Haxhijaha Rahmani

G j y q t a r i,

Avni Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa parashtrohet në këtë gjykatë, për Gjykatën e Apelit - Prishtinë.